

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesit të punës të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Grupit të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y.Merkaj, E.Meta |

Parti Politike: PD, LSI

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator e cila u shty nga dita e djeshme. Në rendin e ditës së mbledhjes kemi një projektakt: “Për miratimin e udhëzuesit të punës të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Grupit të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”. Ky projektvendim vjen si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, do t’i luteshim zotit Merkaj sekretarit të përgjithshëm, të prezantonte projektaktin. Ndërkohë për procedurë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator janë të pranishëm, të pranishëm janë

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

gjithashtu edhe përfaqësues të subjekteve zgjedhore dhe zyrtarë të administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Zoti Merkaj ju lutem!

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 20 pika 1 shkronja “gj” e Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton udhëzuesit dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve. Udhëzuesi i punës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Grupit të Numërimit të Votave së bashku me Kodin Zgjedhor dhe aktet e tjera nënligjore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe materialet informuese, edukuese, do të përdoren në kurset e trajnimit të trajnerëve të KZAZ-ve dhe të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave. Udhëzuesi qartëson detyrat e KZAZ-së dhe GNV-së nga momenti i dorëzimit të kutive me fletë votimi në KZAZ deri në tabulimin e rezultatit të zgjedhjeve për zonën zgjedhore. Ai synon t’iu vij në ndihmë anëtarëve të KZAZ-së dhe GNV-së për veprimtarinë e tyre në administrimin e procesit zgjedhor, vlerësimin, numërimin dhe tabulimin e rezultatit të zgjedhjeve, ku njohja kuptimi dhe përvetësimi i procedurave të parashikuara në këtë udhëzues do të ndikojë në ngritjen e nivelit profesional dhe administrues të anëtarëve të KZAZ-së dhe Grupit të Numërimit të Votave, zgjidhjen me profesionalizëm, pa anshmëri dhe efektivitet nga ana e administratës zgjedhore të të gjitha problematikave të krijuara gjatë ushtrimit të detyrës. Gjithashtu mirëadministrimin e procesit zgjedhor dhe zbatimin ligjor të detyrave të tyre funksionale në përputhje me Kodin Zgjedhor. Udhëzuesi i punës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Grupit të Numërimit të Votave përbëhet nga 6 krerë i ndarë dhe i strukturuar si më poshtë: Në Kreun e Parë, përshkruhen detyrat e Grupit të Numërimit të Votave, organizimin dhe teknologjinë mbështetëse të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për çdo VNV dhe materialet dhe dokumentacioni në bazë të Grupit të Numërimit të Votave. Kreu i Dytë, paraqet në mënyrë të detajuar rregullat për

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore organizimin dhe detyrimin e grupit të marrjes në dorëzim, marrjen në dorëzim të kutive me materialet zgjedhore dhe fletët e votimit si dhe konstatimin e kutive të pa rregullta dhe sistemimin e tyre. Kreu i Tretë, përmban 11 nëndarje dhe qartëson veprimet që kryen me fillimin e numërimit, rradhën e numërimit, vlerësimin e votave dhe kontestimin dhe rivlerësimin e tyre. Kreu i Katërt, përmban veprimet që kryhen nga KZAZ dhe Grupi i Numërimit për plotësimin e tabelave të rezultateve paraprake, hedhjen në trasmetimin elektronik të të dhënave, nxjerrjen e tabelës elektronike dhe nxjerren e tabelës përmbledhëse të rezultatit. Kreu i Pestë, jep informacion për përgjegjësitë dhe sanksionet. Kreu i Gjashtë, jep informacion për procedurën e dërgimit të materialit zgjedhor nga KZAZ në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si dhe modelet ilustruese për vlerësimin e votave të miratuar me vendim nr.14 të vitit 2021 të Komisionit Rregullator. Ky manual synon të ndikojë në rritjen e cilësisë së trajnimit dhe kryerjen detyrave me standarte të larta për anëtarët e KZAZ-ve dhe GNV-ve. Për sa më lartë keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin e mësipërm. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Atëherë, çelim diskutimin në parim për projektaktin. Në këtë fazë të procedurës së pari e kanë fjalën anëtarët e Komisionit Rregullator më tej përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore. Të nderuar kolegë, po zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Faleminderit e nderuar! Atëherë, së pari më lejoni t'iu korrigoj nuk kemi të bëjmë me një shtyrje të mbledhjes së djeshme, të gjithë dje ramë dakord që mbledhja dje u ndërpre pasi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i tërhoqi të dy variantet e aktit të propozuar dhe kjo është thirur sipas rregullores tonë dhe sipas Kodit Zgjedhor është thirur një mbledhje e re, me një akt të propozuar nga Komisioneri. Pra, është mbledhje e re, së pari. Së dyti, unë kisha

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

një kërkesë në fakt për Sekretarin e Përgjithshëm, rastësisht jam vënë në dijeni të një shkresë nga një media mund t'a quajmë drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit Rregullator, e cila nuk na është vënë në dijeni. Kjo shkresë është paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ditën e djeshme dhe ka të bëjë me shtesa apo propozime konkrete për aktin që na është dërguar neve. Kështu që po të doni për korrektesë mund t'iu a vë edhe në dispozicion numrin e protokollit, është numër 3988 protokollit datë 19.04.2021. Kështu që në fakt nuk ka ndodhur herë tjetër, kërkesa drejtuar Komisionit Rregullator mos t'i vihen në dispozicion anëtarëve të rregullatorit. Kështu që nuk e di se çfarë ka ndodhur me këtë shkresë. Gjithashtu gjatë shqyrtimit të projektaktit në tërësi së bashku me kolegen Vukaj, kemi komentet, vëretjet, shtesat, propozimet tona. Kështu që i diskutojmë në vijim ato, faleminderit!

Znj. I. Nano: Po zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në parim doja të shtoja, është një akt i cili vërtet na ka marrë kohë, për hirë të përmbatjes së tij, për hirë të rëndësisë së ditës ku ai do të shfletohet dhe do të orientojë. Bëhet fjalë për Grupet e Numërimit, të cilët do orientohen mbi bazën e këtij manuali apo udhëzuesi dhe ky akt jo vetëm është një material i sinkronizuar me çfarë ne si rregullator kemi vendosur më herët. Por pasqyrohen në të edhe risitë e kodit pa dyshim dhe njëkohësisht risitë e tjera siç janë garancia përmes teknologjisë së lartë, garancia e transparencës së fletës së votimit gjatë numërimit dhe në të njëjtën kohë transparenca ruhet gjatë dhe nuk neglizhohet për asnjë nga fletët e votimit. Këtë kemi vendosur më herët me aktet tona si Komision Rregullator dhe shpresoj dhe mendoj që duhet të përpiqemi t'a implementojmë dhe në këtë udhëzim. Numëruesit duhet të tregojnë integritet të lartë ashtu siç është edhe përmbatja e këtij akti dhe mos të

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

intimidohen nga asnjë lloj praktike tjetër përveçse këtij akti. Ky akt është vijë demarkacioni e asaj dite dhe padyshim që ose do nxjerr numërues të cilët me veprimet e tyre do të dëshmojnë se e respektuan ose do nxjerr numërues të cilët do dëshmojnë që me veprimet e tyre kanë abuzuar, dhe e kanë keqinterpretuar duke e çuar veten në pozitat e të akuzuarit apo të atij që ndiqet penalisht. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Po zoti Çaka!

Z. D. Çaka: Faleminderit zonja Kryetare! Është një akt i cili do t'i vij në ndihmë anëtarëve të Komisioneve të Administrimit të Zgjedhjeve por njëkohësisht dhe mbi të gjitha anëtarëve të Grupeve të Numërimit, për pikërisht për numërimin, për gjithë procedurën që nga fillimi i marrjes në dorëzim të kutive të votimit dhe të kutive të materialeve të votimit, numërimit të votave dhe deri në nxjerrjen e rezultatit për atë Zonë të Administrimit Zgjedhor. Duhet theksuar që ky udhëzues është i rëndësishëm dhe në përmbatje të tij nuk ka asgjë më shumë se një përmbledhje të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që në rradhë të parë Kodi Zgjedhor përmban apo edhe akte të tjera të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Me sa kam vënë re përgjithësisht janë përfshirë shumë fusha të veprimitarisë të dy këtyre komisioneve, pra të Komisionit Zonal të Administrimit të Zgjedhjeve dhe të Grupeve të Numërimit. Besoj që është mbuluar e plotë tabloja e ngjarjeve që do të zhvillohen në atë ditë në Vendet e Numërimit të Votave. Kuptohet që edhe unë kam disa komente, shtesa apo propozime të cilat do t'i bëjmë gjatë shqyrtimit. Por edhe nëse do të ekzistojë ndonjë çështje të cilën besoj që nuk mundet, pra mundet të na ketë kaluar të gjithëve ne besoj që ato janë rregulluar me akte të tjera. Duke përfshirë edhe Kodin Zgjedhor dhe aktet që ne kemi miratuar më parë. Faleminderit!


*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çaka! Unë personalisht do t'i bashkohesha mendimit tuaj, të zonjës Vukaj që folët në parim lidhur me projektaktin. Në fund të fundit kemi të bëjmë me një udhëzues për punën e KZAZ-së dhe GNV-së në procesin e numërimit të votave. Është një akt të cilit i kanë paraprirë edhe akte të tjera me karakter normativ të miratuar nga Komisioni Rregullator. Po citoj vetëm dy vendimin nr.14 të datës 10 Prill për : “Organizimin e Punës në Vendin e Numërimit të Votave, rradhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit në ZAZ për zgjedhjet në Kuvend”, është një akt gjeneralist. Ndërsa kemi një akt tjetër që lidhet vetëm me zgjedhjet në Kuvend të datës 25.04.2021, për: “Kriteret e caktimit të numrit të Grupeve të Numërimit, për çdo Vend të Numërimit të Votave, për caktimin e rregullave për ndarjen e detyrave mes anëtarëve të GNV-ve”. Ky akt vjen për të plotësuar këtë tablo dhe për të ndihmuar Grupet e Numërimit të Votave, për të kryer të gjitha veprimet e domosdoshme sipas rradhës që janë përcaktuar dhe në akte të tjera të rregullatorit. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, kanë diçka në parim? Po zoti Kaziaj!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Thjesht edhe për ne akti është një akt i një rëndësie të posaçme, është pjesa konkludive le të themi e një procesi të lodhshëm që është marrë me akte me ndryshime të bëra në pjesën e vitit 2020, në Kodin Zgjedhor dhe akte normative të marra nga ana juaj si Komision Rregullator. Po ashtu dhe nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është një akt shumë i rëndësishëm. I cili normon të themi pjesën përfundimtare të procesit që ka të bëjë me numërimin dhe me të gjitha pjesët e tjera të lidhura me të. Kemi marrë dijeni diku.. sot nga ora 14:00 për aktin. Jemi njohur me të dhe në vazhdim do të kemi dhe propozime për shtesa, ndryshime.

Znj. I. Nano: Faleminderit. Po zoti Nuraj.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Mbasi jemi njohur me relacionin që na ka ardhur sot nga Administrata e KQZ-së dhe me ndryshimet përkatëse që kanë bërë në aktin e ri të propozuar. Pasi e pamë dhe u njohëm me këto ndryshime në parim shprehim dakord. Kështu që mund të vazhdoni.

Znj. I. Nano: Faleminderit. Atëherë, të nderuar kolegë kalojmë në votimin në parim të projektaktit “Për miratimin e udhëzuesit të Komisionit të Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupit të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

Kush është dakord në parim me projektaktin?


Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet në parim!

Kalojmë në diskutimin nen për nen. Paraprakisht më lejoni të them që akti ka vetëm 3 nene. Por, neni 2 dhe 3 janë e drejta e ankimit dhe hyrja në fuqi dhe publikimi. Kështu që neni 1, po lexoj neni 1 dhe pastaj po kalojmë tek përmbajtja e materialit bashkëlidhur. Që në fakt është përmbajtja e aktit. Neni 1 – Të miratojë

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

udhëzuesin për Komisionin e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupin e Numërimit të Votave në ndihmë të anëtarëve të grupeve të numërimit dhe KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 sipas materialit bashkëlidhur. Këtu çelim diskutimin për nenin 1. Që në fakt është diskutimi për materialin bashkëlidhur. Dukeqenëse materiali bashkëlidhur është voluminoz do t'u lutesha qoftë kolegëve qoftë përfaqësuesëve të subjekteve zgjedhore që ta nisim me rradhë. Duke nisur nga titulli, përmbajtja dhe pastaj nga krerët. Përderisa nuk kemi nene por kemi krer, nënkrer, si mendoni? Pra dikush mund të ketë një propozim për KREU-n VII dikush për KREU-n I ta fillojmë sipas krerëve ose si e mendon zoti Çakaj?

Z. M. Çakaj: Ne kemi punuar me kolegen Vukaj dhe kemi nxjerr bashkërisht komentet tona. I kemi përmbledhur në mënyrë integrale. Nëse e gjykoni ju të arsyeshme ne i themi të pestë komentet, shtesat dhe propozimet që kemi ne lidhur me aktin e propozuar nga Komisioneri. Më pas sigurisht kemi dhe bazën ligjore përkatëse për çdo propozim konkret apo ndryshime. Pastaj sipas procedurës së miratuar e hedhim në votim ose diskutim si ta shihni të arsyeshme.

Znj. I. Nano: Unë thash thjesht për rradhën. Pra, nëse ka një shtesë tek KREU I që ta dimë e mbyllim KREU-n I. Mbyllim KREU-n II e kështu me rradhë. Pastaj do të kalojmë në tërësi gjithë materialin.

Z. M. Çakaj: Me rradhë janë që të gjitha.

Znj. I. Nano: Atëherë, nisim me nenin 1 që do të thotë me materialin bashkëlidhur. Zoti Çakaj ju do të nisni? Zonja Vukaj?

Z. M. Çakaj: Atëherë..

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Znj. H. Vukaj: Në fakt që në krye të herës pra që po t'i referohemi rregullave të etikës gjejmë një.. në paragrafin e parë diku nga fundi i paragrafit të parë. Pas fjalës “propozuar nga zgjedhësit” kemi “anëtarët e Komisioneve Zgjedhore gjatë kryerjes së detyrës”. Në fakt bëhet fjalë për anëtarët e GNV-ve. Do t'i konsiderojmë thjesht gabime materiale këto apo zëvendësuese? Apo ta shprehim si propozim? Që mos të hanim kohën.

Znj. I. Nano: Mendoj që janë të dyja. Po zoti Meta.

Z. E. Meta: Është dhe KZAZ-ja dhe GNV-ja.

Znj. I. Nano: Është dhe KZAZ-ja dhe GNV-ja.

Znj. H. Vukaj: Pra, duhet përfshirë atëherë. Atëherë, që mos të hamë kohën e propozimeve. Do të thosha dikush që evidenton gabime ortografike apo të një karakteri teknik që nuk prishi thelbin. Por, që duket qartë që është harruar ose është mbartur padashje mund ta shprehim them gjatë rrugës së propozimeve.

Znj. I. Nano: Patjetër, pra ato që janë të korigjueshme nga Administrata pa pasur nevoj për votimin tonë. Pra, për vullnetin tonë për të ndryshuar në përmbajtje. Sigurisht, meqenëse jemi këtu ja po them edhe unë një për shembull. Në të njëjtën fjali që lexoj zonja Vukaj thuhet “në mënyrë rregullat e etikës për t'iu përmbjatur parimeve bazë të administrimit të zgjedhjeve siç parashikohet në ligj. Në mënyrë të veçant kërkesave për legjimitet, transparencë, paanashmëri, profesionalizëm dhe në mënyrë të propozuar nga zgjedhësit” duhet të këtë qenë “në mënyrë të pavarur dhe”. Pra, të tilla korigjime mund t'i bëjmë gjatë tekstit besoj pa pasur nevoj për të kaluar.. pra pa i konsideruar propozime për t'i votuar. Kështu që unë bie dakord me zonjën Vukaj për këtë gjë.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Znj. H. Vukaj: Idea është që gjithë secili nga ne në momentin kur ka një propozim mjafton ta nominojë që është propozim dhe pastaj e konsiderojmë si të tillë. Kurse pastaj dëshirën e mirë për të kaluar gabimet ortografike ose të natyrës njerëzore besoj e gjejmë gjatë rrugës.

Znj. I. Nano: Ta vërë në dukje. Pra, kjo që diskutuam unë dhe zonja Vukaj këto të paktën në të njëjtën pjesë nuk janë për t'u votuar apo jo?

Znj. H. Vukaj: Jo, këtu për shembull kemi tek pjesa e rregullave të etikës “T’i ofrojmë votuesit” diku në mes të pikave “t’i ofrohet çdo votuesi cilësinë më të lartë të shërbimit të kërkuar që zgjedhësit të ushtrojnë të drejtat e tyre në respektim të plot të të drejtave dhe procedurave ligjore”. Këtu bëhet fjalë kryesisht për numëruesit. Domethënë nuk bënë sens pika. Nuk mund t’i ofrojë dot votuesve numëruesi. Domethënë është..

Z. E. Meta: Rregullat e etikës për Administratën Zgjedhore janë njësoj për të gjitha.

Znj. H. Vukaj: Por rregullat e etikës mund të jenë të përgjithshme. Por, problemi është që disa rregulla etike nuk iu mbarten ose nuk iu vishen dot.

Z. M. Çakaj: Më fal, në titull projektakti i paraqitur për miratim lexon “Udhëzues i punës për KZAZ dhe GNV”. A mund ta dimë se çfarë mund t’iu ofrojë KZAZ-ja apo GNV-ja çdo votuesi cilësi më të lartë? Nderkohë që bëhet fjalë për që nga momenti i marrjes së materialeve zgjedhore. Pra, procesi i punës është pika fundore e administrimit të zgjedhjeve. Pra, nga momenti i marrjes së kutisë me fletët e votimit dhe kutive me materialet e votimit i dorëzohen nga komisionet e qendrave të votimit i dorëzohen Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor. Kështu që besoj ka të drejtë kolegja Vukaj. Nuk kemi të bëjmë me votuesin sepse

*Zbardi materialin audio
Jonida SALILLARI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

është një akt tjetër i cili e kemi miratuar po ne dhe ka të bëjë me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të komisioneve të qendrave të votimit. Që është i lidhur ngushtësisht me votuesit. Megjithatë..

Znj. I. Nano: Ta konsiderojmë propozim për ta hequr këtë paragraf?

Z. M. Çakaj: Unë kam përshtypjen që ka ngelur nga akti i mëparshëm. Kështu që nuk është se na cënon. Megjithatë unë dhe për ekonomi të kohës vazhdoj t'i mbetem propozimit. T'i lexojmë këtu komentet apo shtesat apo propozimet që kemi mbi aktin sepse akti është shumë voluminozë. Pjesa tjetër pra, çfarë propozime bëjë unë dhe zonja Vukaj i marrim i diskutojmë, i shqyrtojmë, debatojmë dhe pjesa tjetër konsiderohet të paktën për ne në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet normative.

Znj. I. Nano: Filloni me propozimet unë ja dhash fjalën zonjës Vukaj.


Z. M. Çakaj: Njësoj veprojmë dhe për propozimet apo shtesat që mund të keni ju. Për ekonomi të kohës.

Znj. I. Nano: Secili nga anëtarët patjetër që mund të bëjë propozimet e veta. Atëherë, fillojmë zoti Çakaj. Të lutem vetëm faqen që të orientohemi.

Z. M. Çakaj: Po, dakord. Në pikën 6 të aktit ku bëhet fjalë për vëzhguesit. Atëherë, në faqen 10 të udhëzuesit. Tek tabela është parashikuar një vëzhgues për OJF. Në fakt neni 6 i Kodit Zgjedhor parashikon që përfaqësuesit, vëzhguesit e OJF-ve duhet të jenë 2. Kështu që unë.. të huaj duhet të jenë 2. Neni 6 parashikon jo më pak se 2.

Znj. I. Nano: Në qendër votimi besoj e parashikon neni 6 jo në VNV.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Z. M. Çakaj: Vëzhguesi thotë.

Znj. I. Nano: Po pra, në..

Z. M. Çakaj: VNV.

Znj. H. Vukaj: Në çdo tavolinë.

Znj. I. Nano: Është duke folur zoti Çakaj zoti Nuraj, faleminderit.

Z. M. Çakaj: E Nderuar ju përpara e keni kodin mund ta verifikoni.

Znj. I. Nano: Ju lutem mundet neni 6 cila pikë?

Z. M. Çakaj: Keni dhe pikën 4.

Znj. H. Vukaj: Dukeqenëse në materialin që erdhi ka qenë 2 dhe më pas është zëvendësuar me numrin 1 i lutem Administratës ku është bazuar që ka hequr numrin 2 dhe ka vendosur 1? Tek cila dispozitë? Ka qenë 2 dhe është bërë 1, vëzhgues.

Z. M. Çakaj: Më lejoni të lexoj pak nenin 6 të Kodit Zgjedhor. Pika 4 : Akreditimi i vëzhguesëve pranë komisioneve zgjedhore. A janë komisione? Komisione Zgjedhore janë të gjitha edhe KZAZ-ja..

Znj. I. Nano: GNV-ja.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Z. M. Çakaj: Po edhe KZAZ-ja sepse sapo e thamë. Sapo e deklarojë Drejtori. Një Organizatë Joqeveritare Shqiptare apo koalicion i tillë, parti politike ose kandidat i propozuar nga zgjedhësit nuk mund të ketë në të njëjtën kohë më shumë. Çdo Organizatë Joqeveritare e Huaj si dhe Organizatë Ndërkombëtare nuk mund të kenë në të njëjtën kohë më shumë se 2 vëzhgues të huaj në një qendër votimi. Tani.. *(diskutimi ndërmjet tyre nuk dëgjohet)* Po është e ndalur të ketë 2 vëzhgues në vendin e numërimit të votave?

Znj. I. Nano: Jo, është tjetër propozimi për 2 vëzhgues. Por, unë nuk e shoh të jetë parashikimi i kodit, meqenëse iu referuat nenit. Në qendër votimit po.

Z. M. Çakaj: Atëherë, parashikimi i kodit..

Znj. H. Vukaj: Unë i bëra një pyetje Administratës ku është bazuar?

Z. M. Çakaj: Po mirë më fal. Ku është bazuar pika? Atëherë bashkohem unë me pyetjen. Ku është bazuar që parashikon një vëzhgues?

Z. Y. Merkaç: Atëherë, idea ishte kështu meqenëse kishte 2 vëzhgues në kemi.. pika 3 tek tabela thotë “Vëzhguesi i huaj mund të shoqërohet dhe nga një përkthyes brenda ambienteve”. Kemi vendosur një vëzhgues dhe një përkthyes.

Znj. H. Vukaj: Po ku jeni bazuar?

Z. M. Çakaj: Pra, e plotësoni numrin 2 me përkthyesin?

Z. Y. Merkaç: Po.

Znj. H. Vukaj: Përkthyesi nuk ka funksion fare. Është si të ishte një program.

Z. Y. Merkaç: Po thjesht është prezenca në vendin e numërimit të votave.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Z. M.Çakaj: Propozimi i parë është që të jenë dy vëzhgues. Propozimi i dytë, po në nenin 6, referuar nenit 121 të Kodit Zgjedhor rezulton se në vendin e numërimit të votave duhet të qëndrojnë vetëm anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së, anëtarët e grupeve të numërimit të votave, të caktuar me vendim të KZAZ-së, të cilët futen në punë, kandidatët, vëzhguesit e akredituar, përfaqësuesit...

Znj. I.Nano: Zoti Çakaj, që të orientohem, lutem më refero?

Z. M.Çakaj: Po, në faqen 10, poshtë tabelës.

Znj. I.Nano: Në faqen 10 të manualit dhe referoheni në ndonjë nen të Kodit në këtë që po thoni apo po lexoni, ju lutem?

Z. M.Çakaj: Nuk po e lexoj, s'ka ardhur akoma propozimi. Operatorët e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave, personeli teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave, stafi i KQZ-së i pajisur me autorizim të posaçëm nga KQZ-ja. Kujdes! KZAZ merr masa dhe është përgjegjëse për moslejimin e personave të paautorizuar dhe të paakredituar nga KQZ ose KZAZ. KZAZ përgatit listën me emrat e personave që lejohet të hyjnë në VNV, e cila vuloset me vulën e KZAZ-së. Cakton dy anëtarë të saj, të cilët pajisen me këtë listë dhe lejojnë të hyjnë në VNV, çdo person që është pajisur me autorizim/akreditim të lëshuar nga KQZ-ja ose KZAZ-ja dhe dokumenti i identifikimit të vlefshëm, i përputhin të dhënat e dokumentit të identifikimit, autorizimit të akreditimit të lëshuar nga KQZ-ja ose KZAZ-ja me emrin, mbiemrin që gjendet në listë. Tani, çfarë ka ndodhur?! Në votimet e vitit 2019, shumë përfaqësues të medias nuk janë lejuar të hyjnë nëpër VNV, me pretendimin se nuk e kanë emrin në listë. Tani, po neni 6 i Kodit Zgjedhor parashikon që,

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

përfaqësuesit e medias kanë të drejtë të hyjnë lirisht në KQZ, për sa kohë ata, së pari, akreditoohen pranë Komisionit Qendror Zgjedhor dhe pajisen me autorizim nga KQZ-ja ose Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Ata kanë të drejtë të hyjnë në çdo qendër votimi, që do të thotë, brenda një dite, një përfaqësues i medias mund të hyjë në Tiranë, potencialisht në të gjitha KZAZ-të e Tiranës, por edhe në qarqe të tjera, në Elbasan, Durrës. Ajo çfarë propozoj unë në rastin konkret, është që krahas kësaj pike, përjashtimisht për përfaqësuesit e medias, ata të lejohen me autorizim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të hyjnë në çdo Komision Qendre Votimi, Komision Zonal të Administrimit të Zgjedhjeve dhe çdo VNV, dhe kërkesën time e mbështes në bazë të nenit 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Propozimi i tretë.

Znj. I.Nano: Keni numër këtu, se në rastin e parë kishit dy? Numri dy vëzhgues, këtu keni numër të propozimit?

Z. M.Çakaj: Po, të gjithë përfaqësuesit e medias, të cilët janë pajisur me autorizim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kanë të drejtë të hyjnë në vendin e numërimit të votave sepse janë përfaqësues të medias.

Znj. I.Nano: Pra, ata që janë të akredituar?

Z.M. Çakaj: Të gjithë personat, çfarë janë akredituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Znj. I.Nano: Përfshirë gjithë përfaqësuesit e mediave? Pra, gjithmonë bëjmë fjalë për përfaqësues të akredituar të medias.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Z. M.Çakaj: Gjithmonë për përfaqësues të akredituar të medias, por nuk bëhet akreditimi në KZAZ, akreditimi bëhet pranë KQZ-së, që do të thotë, e merr akreditimin për të vëzhguar zgjedhjet që do të mbahen në 25 prill në Republikën e Shqipërisë dhe me këtë akreditim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk mund t'i dalë një përfaqësues atij të KZAZ-së dhe t'i thotë, ose dy siç është më poshtë në akt, dhe t'i thotë, i nderuar zoti gazetar, ti nuk ke të drejtën të marrësh pjesë, të hysh në këtë, sepse nuk e ke emrin në listë! Kjo ka ndodhur në 2019. Ka ndodhur dhe në 2017, por në 2019 ka ndodhur rëndom kështu që, besoj të gjithë biem dakord që liria e shtypit është një nga të drejtat kushtetuese, parashikuar nga neni 22 i Kushtetutës, kështu që nuk mund edhe në konceptin e jurisprudencës nuk mundet, që ne me një akt normativ nënligjor të heqim këtë të drejtë kushtetuese.

Znj. I.Nano: Kush po e heq këtë të drejtë kushtetuese, se tani të mos kalojmë në format deklarimesh? Propozim i bazuar. Ju thatë nenit 6, unë po i referohem nenit 121. Neni 121 thotë, përfaqësues të akredituar të medias janë në VNV, pra është tjetër gjë në qendër votimi, tjetër në VNV.

Z. M.Çakaj: Vazhdojmë me propozimin tjetër?

Znj. I.Nano: Kush ishte propozimi ju lutem?

Z. M.Çakaj: Propozimi ishte, përfaqësuesit e medias me autorizim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kanë të drejtë të hyjnë në çdo KQV, KZAZ dhe VNV.

Znj. I.Nano: Kanë të drejtë?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Z.M. Çakaj: Po pra, kanë të drejtë të hyjnë. Kudo edhe këtu.

Znj. I.Nano: Në çdo KQV?

Z. M.Çakaj: KZAZ dhe VNV. Nuk mund që të dalin dy persona të KZAZ-së dhe t'i thonë, nuk e ke emrin në listë. Kështu ka ardhur akti. Faleminderit!

Znj. I.Nano: Po, zoti Merkaj?

Z. Y.Merkaj: Kemi miratuar 3 udhëzues. Udhëzuesi i KZAZ-së, udhëzuesi i QV-së dhe udhëzuesi i GN-së. Tani, më duket se i kemi parashikuar tek ato dy aktet e para, në qoftë se do ta shtojmë edhe këtë? Kjo ka të bëjë vetëm me vendin e numërimit të votave, nuk ka të bëjë me qendrën e votimit.

Z. M.Çakaj: Po, pra po vendi i numërimit të votave është, aty është instaluar dhe KZAZ-ja.

Z. Y.Merkaj: S'mund t'i thuash anëtarëve të grupit të numërimit ti, që do të lejosh media në qendër votimi.

Z. M.Çakaj: Urdhëro?

Z. Y.Merkaj: Nuk mund t'i thuash në këtë akt anëtarit të grupit të numërimit që do të lejosh media në qendrën e votimit, kështu e kuptoj unë.

Znj. H.Vukaj: Zoti Merkaj, kam përshtypjen që s'ju lejohet replika.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Z. M.Çakaj: Qëllimi është për KZAZ-të dhe VNV-të, dakord?

Znj. H.Vukaj: Pavarësisht mendimit tuaj dhe përvojës, nuk lejohet replika.

Z. M.Çakaj: Në 2019, Komisionet e njëanshme të zonave të administrimit zgjedhor i kanë penguar të gjithë përfaqësuesit e medias me arsyetimin, me një akt të ngjashëm, se ju nuk e keni emrin në listë. Dakord? Kjo ka ndodhur dhe është bërë i njëjti propozim. Propozimi i tretë ka të bëjë me procesin e regjistrimit të votës nga kamerat, pra, teknologjinë në procesin e numërimit.

Znj. I.Nano: Në cilën faqe, ju lutem zoti Çakaj, të manualit, udhëzuesit?

Z. M.Çakaj: Nuk e ka nxjerr faqen, për këtë arsye ndoshta edhe jemi kufizuar, por bëhet fjalë përpara faqes 9, që teorikisht i bie faqja 8 në fakt, por mungon numri 8. Atëherë kalojmë tek paragrafi, GNV përfundon numërimin e kutisë, pra në rast se GNV funksionon me dy anëtarë, detyrimisht ky proces duhet të jetë i regjistruar nga kamerat e teknologjisë mbështetëse të instaluar në ambjentet e VNV-së. Në rast se regjistrimi me kamera nuk funksionon, për çfarëdo arsye dhe numërimi i kutisë nuk ka përfunduar. atëherë GNV përfundon numërimin e kutisë së kësaj QV-je dhe procesi ndërpritet deri në vënien në funksionim të teknologjisë mbështetëse ose plotësimit të grupit të numërimit të votave. Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator, me vendimin nr.8 të Komisionit Rregullator, të datës 09 shkurt 2021, në nenin 8, pika 4, gjithë ne kemi miratuar në mënyrë unanime se procesi i regjistrimit nga kamera do të kryhet për çdo fletëvotimi. Me këtë propozim, potencialisht rrezikon, që në rast se në një kuti ndodhen 400 fletë votimi mesatarisht, apo 500 fletë votimi dhe numërohen 200 apo 250 dhe ky proces regjistrohet nga kamera, gjysma e këtyre, me këtë propozim, nuk do të

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

ketë të njëjtin standard, siç e ka fatin gjysma e regjistruar nga kamera. Pra, potencialisht nuk kemi të bëjmë me të njëjtin standard të regjistrimit të fletës së votimit dhe potencialisht çdo subjekti zgjedhor apo kandidati të propozuar nga zgjedhësit, i hiqet mundësia për të pasur një indicie në një situatë eventuale ankimimi për atë. Unë mendoj që vota është e barabartë dhe të njëjtën garanci për procesin e regjistrimit nga kamera, të votave të subjektit zgjedhor, të njëjtin garanci duhet të kenë dhe ato vota në rast se nuk funksionon kamera, propozimi im në rastin konkret do të ishte. Në rast se regjistrimi me kamera nuk funksionon për çfarëdo arsye dhe numërimi i kutisë nuk ka përfunduar, atëherë fletët e votimit futen në kuti, mbyllen, me kode sigurie dhe procesi numërimit rifillon vetëm në rast të vënies në funksionim të kameras.

Z. Y.Merkaj: Më fal, mundem? Vendimi nr.14 i Komisionit Rregullator, neni 3, pika 4, është transpozuar në mënyrë fjalë për fjalë tek kjo që sapo lexuat ju. Vendimi 14, neni 3, pika 4, bie në kundërshtim, sepse ne kemi fjalë për fjalë siç është tek vendimi nr.14.

Z. M.Çakaj: Unë nuk mbaj mend të kem miratuar ndonjë vendim që kemi thënë, ndërpritet procesi. Jeni të sigurt për këtë? Atëherë ndërpritet mbledhja këtu urgjentisht. Të lutem, merr pak pesë minuta pushim!

Znj. I.Nano: Pesë minuta pushim, ju lutem!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Rifillon Mbledhja

Ora 23:15

Znj. I. Nano: Përshëndetje, pas një ndërprerje relativisht të gjatë kthehemi në mbledhjen e Komisionit Rregullator. Ndërprerja ishte dhe për shkaqe teknike prandaj mbledhemi në këtë orë. Në momentin e ndërprerjes së mbledhjes ishim duke diskutuar nenin 1 të projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionin e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve dhe Grupin e Numërimit të Votave në ndihmë të anëtarëve të KZAZ-ve dhe GNV-ve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021” sipas materialit bashkëlidhur. Materiali bashkëlidhur është pikërisht udhëzuesi. Një udhëzues voluminoz të cilin e ka përgatitur Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë periudhës së ndërprerjes Komisioni Rregullator ridiskutojë tekstin e udhëzuesit për ta sjellë atë në përputhje me vendimet e marra më herët nga Komisioni Rregullator. Diskutojmë propozimet e bëra publike në mbledhje para ndërprerjes të zotit Çakaj, propozimet e zonjës Vukaj, propozimet e zotit Çaka dhe propozimet e mia dhe biem dakord me tekstin përfundimtar të manualit. Të nderuar kolegë nëse nuk keni diçka më lejoni të votojmë, të kalojmë për votim nenin 1 pasi jemi në momentin e votimit nen për nen të projektaktit. Kemi diçka para se të kalojmë për votim të nenit 1? Nëse jo iu ftoj të votojmë nenin 1 të projektvendimit.

Kush është dakord ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALIÇLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2021*

Neni 2 – Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Administrative të Apelit, Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Neni 3 – Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Atëherë, kemi votuar në parim, kemi votuar nen për nen është momenti të votojmë në tërësi projektvendimin “Për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionin e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve dhe Grupin e Numërimit të Votave në ndihmë të anëtarëve të KZAZ-ve dhe GNV-ve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

Kush është dakord në tërësi me projektvendimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Atëherë, dukeqenëse nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës apo jashtë rendit të ditës e deklaroj mbledhjen të mbyllur. Natën e mirë!

Vendimi nr.20

*Zbardhi materialin audio
Johida SALILLARI*

